

Dërgesat nga Afganistani dhe ndikimi i tyre në ekonominë e vendit

Përmbledhje Ekzekutive

Në fund të tetorit 2011, një shtetase e Kosovës nga qyteti i Ferizajt humbi jetën në Afganistan. E ndjera ishte e punësuar në kompanitë kontraktuese amerikane. Një numër i madh i kosovarëve janë të punësuar në këtë vend. Sipas të dhënave të grumbulluara nga Instituti GAP gjatë muajve shtator-nëntor 2011, del se rreth 2.100 kosovarë aktualisht punojnë në Afganistan. Kosovarët në Afganistan kryejnë punët si mekanik, vozitës kamionësh, marangoz, mirëmbajtës të pajisjeve, etj. Pagat e kësaj kategorie të të punësuarve jashtë vendit derdhen në xhirollogaritë bankare në Kosovë. Sipas të dhënave të grumbulluara nga bankat komerciale në Kosovë, del se nga Afganistani kosovarët në total marrin 50-55 milion euro në vit, që do të thotë se të ardhurat nga Afganistani janë të ardhurat më të larta për person, nëse krahasohet me dërgesat nga vendet tjera dhe numrin e shtetasve kosovar të punësuar në vendet tjera. Nëse i krahasojmë dërgesat nga Afganistani me dërgesat e kosovarëve nga vendet tjera, del se pas Gjermanisë dhe Zvicrës, Afganistani është vendi i tretë prej nga më së shumti vijnë dërgesat në para. Deri më tani, institucionet publike nuk kanë vënë asnjë lidhje institucionale me këtë kategori të të punësuarve, kompanitë në të cilat ata punojnë apo shtetin ku ata ndodhen. Institucionet publike, nevojitet që të mbajnë evidencën e këtyre shtetasve kosovarë të cilët ndodhen në zonat e luftës, dërgesat nga ky vend të përlllogariten nga Banka Qendrore në analizat e saj vjetore për remitencat, kurse bankat komerciale duhet të ulin tarifat për dërgesat nga jashtë me qëllim që edhe të punësuarit në vendet perëndimore të përdorin më shumë sistemin bankar për të transferuar paratë në Kosovë. Kjo do të ndikonte që të kemi një pasqyrë më të qartë të dërgesave të emigrantëve për në Kosovë.

Hyrje

Kushtet e pafavorshme ekonomike kanë bërë që shumë kosovarë të kërkojnë punë jashtë vendit. Një në katër shtëpi vlerësohet se ka të paktën një anëtar të familjes i cili ka emigruar. Sondazhi i Institutit të Hulumtimeve Gallup¹, pas anketimeve në 135 vende të botës, e radhit Kosovën ndër vendet me më së shumti dërgesa të pranuar, respektivisht 23% e popullatës pranojnë dërgesa nga jashtë, e cila njëherazi është edhe më e larta në rajon. Dërgesat nga jashtë përbëjnë të ardhurat kryesore për shumë familje kosovare dhe kanë një ndikim pozitiv në ekonominë e vendit.

Edhe pse deri me tani shumica e dërgesave kanë ardhur nga Zvicra dhe Gjermania, kohëve të fundit po vërehet një fluks i madh i të ardhurave nga shtetet e Azisë, si Afganistani e Iraku. Një numër i konsiderueshëm i kosovarëve janë punësuar në kompanitë amerikane të cilat merren me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e bazave ushtarake në këto dy vende, si dhe në sektorë tjerë jashtë bazave ushtarake. Pas zvogëlimit të forcave ushtarake në Irak, një numër i madh i bazave ushtarake janë mbyllur dhe si rrjedhojë ka rënë edhe numri i të punësuarve në këtë shtet. Kurse, edhe më tutje ekziston një numër i madh i punonjësve të huaj të angazhuar në Afganistan.

Në këtë publikim, Instituti për Studime të Avancuara GAP analizon dërgesat nga Afganistani dhe ndikimin e tyre në ekonominë e vendit. Kjo analizë përmban të dhënat për procedurat dhe kushtet e punësimit të kosovarëve në Afganistan; numrin e përgjithshëm të të punësuarve; shumën totale të të hyrave vjetore nga ky vend; zonat prej nga vijnë pjesa më e madhe e të punësuarve kosovar në Afganistan; dhe, mos interesimin e institucioneve publike kosovare ndaj shtetasve kosovarë të punësuar në zonat e luftës.

Emigrimi dhe dërgesat në Kosovë

Kosovarët kanë pasur disa periudha të emigrimit masiv që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar. Sot, emigrimi i kosovarëve vlerësohet prej 0.4-1% të popullatës aktive për punësim². Me një papunësi prej 44% dhe një varfëri të skajshme prej 17% dërgesat vazhdojnë të jenë burimi kryesor i mbijetesës për shumë familje. Një studim i USAID³ tregon se dërgesat nga jashtë kanë ndikuar pozitivisht në të gjitha rajonet, megjithatë ndikim më të lartë kanë rajonet më pak të zhvilluara, duke zvogëluar kështu pabarazinë në të ardhurat mesatare për kokë banori. Dërgesat e emigrantëve në Kosovë kanë shënuar rritje ndër vite (përpos në vitin 2009 kur është shënuar rënie e dërgesave si pasojë e krizës financiare globale), duke arritur pothuajse në


¹ Organizata Gallup, Sondazhi mbi remitancat <http://www.gallup.com/poll/147446/three-percent-worldwide-international-remittances.aspx>

² Raporti i Bankës Botërore "Memorandumi Ekonomik i një shteti: 'Kosovo Unlocking Growth potential: Strategies, Policies, Actions'", 2010

³ USAID dhe UNDP, "Studimi i Remitencave në Kosovë 2010"

dyfishin e investimeve të huaja direkte në vend. Në vitin 2010 dërgesat e emigrantëve të pranuar në Kosovë ishin 511.6 milion euro, përderisa Investimet e Huaja Direkte ishin 311.2 milion euro.

Grafikoni nr.1: Remitancat dhe Investimet e Huaja Direkte në Kosovë 2007-2010



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kanalet për dërgimin e parave në Kosovë

Ekzistojnë rrugë të ndryshme për dërgimin e dërgesave nga emigrantët kosovarë, e ndër më të përhapurat janë ato përmes të afërmeve, bankës apo përmes agjencive për transferimin e parave. Pranimi i parave nëpërmjet kanaleve institucionale, të tilla si bankat apo agjencitë e transferimit të parave, ka shënuar rritje, megjithatë ato vazhdojnë të jenë më të ulëta se dërgimi i parave përmes kanaleve joformale, siç janë të afërmit që është 37% krahasuar me dërgesat përmes bankës me 16%, përmes agjencive të transferimit të parave me 23%, postat zyrtare me 24%, etj⁴. Kjo vjen si rezultat i tarifave të larta të transferimit të parave përmes bankave, e që janë më të lartat krahasuar me shtetet e rajonit. Në tabelën e më poshtme kemi krahasuar tarifën që aplikojnë bankat në rajon për transferimin e dërgesave:

Tabela nr.1: Tarifët e bankave komerciale për transferimin e parave në vendet e rajonit dhe Kosovë

Shteti	Tarifët për 100 euro	Tarifët për 500 euro
Kosova	5	10
Shqipëria*	7	7
Bosnja dhe Hercegovina	5	5
Kroacia	1	1
Maqedonia**	0	0
Mali i Zi	2	2.5
Serbia***	0	0

Burimi: Raporti i Bankës Botërore "Memorandumi Ekonomik i një shteti: Kosova" 2010

Shpjegim: *Shumë banka kanë prezantuar marrëveshje me shtetet si Greqia dhe Italia (ku edhe fluksi i emigrantëve është më i lartë) duke mos tarifuar dërgesat e emigrantëve

** Nëse paratë mbahen në bankë për një kohë të caktuar (7-30ditë)

***Nëse paratë mbahen në bankë për 30 ditë, në të kundërtën tarifa është 2 euro

⁴ USAID dhe UNDP, "Studimi i Remitencave në Kosovë 2010"

Megjithatë, duhet theksuar se mënyra e dërgesës së parave dallon varësisht nga shteti prej nga vijnë dërgesat e emigrantëve. Për shembull, dërgesat nga Belgjika, Britania e Madhe, Franca, shtetet Skandinave vijnë kryesisht përmes agjencive për transferim parash. Përmes të afërmeve vijnë dërgesat nga Gjermania, Zvicra, Sllovenia, etj. Ndërsa përmes bankave vijnë dërgesat nga shtetet si Afganistani, SHBA-ja, Kanadaja⁵, etj.

Dërgimi përmes bankave ka disa përparësi. Sikurse emigrantët të dërgonin paratë e tyre përmes bankave, ne sot do të kishim të dhëna të sakta rreth numrit të emigrantëve nga Kosova, do të dinim shumën e dërgesave të parave, dhe për më tepër këto të hyra do të përdroreshin si bazë për depozita, të cilat do të shërbenin për rritjen e performancës kreditore. Gjithashtu, të dhënat e sakta rreth dërgesave nga jashtë janë të rëndësishme për hartimin dhe vlerësimin e politikave, të cilat ndikojnë direkt në rolin zhvillues të tyre në ekonomi dhe kanalizimin e tyre drejt nevojave të vendit për zhvillim.

Dërgesat në para të cilat vinë në Kosovë kryesisht përmes bankave janë dërgesat e punonjësve kosovarë në Afganistan.


Të punësuarit dhe të hyrat nga Afganistani

Nga korriku i vitit 1999, kur forcat e KFOR-it hynë në Kosovë, qytetarëve kosovarë iu ofrua mundësia që të punonin për kontraktorë të huaj. Kampi *Bondsteel*, si baza më e madhe ushtarake në vend, ka punësuar një numër të konsiderueshëm të kosovarëve, sidomos të komunave të rajonit të Anamoravës. Fillimisht në *Bondsteel* kanë punuar rreth 2.500 kosovarë, ndërsa sot janë të punësuar rreth 700. Përmes *Bondsteel* shumë kosovarë panë mundësinë e punësimit në Afganistan e Irak. Që nga viti 2001 kur forcat e ushtrisë Amerikane u futën në Afganistan, një numër i madh i kosovarëve u punësuan atje si personel ndihmës i ushtrisë, përmes kompanisë kontraktuese KBR (Kellogg Brown&Root). Me reduktimin e forcave ushtarake amerikane në Kosovë u reduktua edhe numri i punëtorëve kosovarë në *Bondsteel*, por u hapen shumë mundësi të reja në Afganistan, duke e radhitur kështu Afganistanin si vendin më të kërkuar për punësim jo vetëm nga kosovarët por edhe nga vendet tjera të rajonit dhe botës.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga bankat komerciale në Kosovë, intervistat me të punësuarit në Afganistan dhe të dhënave të kompanive kontraktuese, del se në Afganistan janë të punësuar mbi 2.100 kosovarë. Pjesa më e madhe e kosovarëve janë të punësuar në kompaninë kontraktuese FLUOR Group, e cila në korrik 2011 kishte 868 kosovar të punësuar. Pjesa tjetër e kosovarëve janë të punësuar në kompanitë si Dyncorp International, Service Employees dhe Ecolog INTL FZE.

⁵ Banka Qendrore e Kosovës "Dërgesat sipas shteteve", <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

Grafikoni nr.2: Shpërndarja e punëtorëve kosovar sipas kompanive kontraktuese



Sipas agjencive të cilat janë marrë me ndërmjetësimin e kandidatëve për punë me kompanitë kontraktuese dhe kanë kryer shërbime me pagesë për plotësimin e aplikacioneve për punësim, nga viti 2001 e gjer më 2011, ndërmjet 7.000-8.000 persona kanë qenë të punësuar nga Kosova në Afganistan⁶.

Këto kompani kontraktuese kanë punëtorë nga vendet e ndryshme të botës, në të cilat mbizotërojnë shtetasit amerikanë, indian, filipinez, etj. Vetëm Flour Group ka të punësuar rreth 13.000 punëtorë nga vendet e ndryshme të botës, udhëhequr nga SHBA me mbi 5.200 punëtorë dhe India me rreth 2.100 punëtorë. Punëtorët nga Ballkani gjithashtu kryesojnë në listën e të punësuarve në këtë kompani, kështu Maqedonia dhe Bosnja kryesojnë në numrin e të punësuarve në rajon, të pasuar nga Kosova.

Tabela nr.2: Numri i të punësuarve nga vendet e Ballkanit në kompaninë më të madhe kontraktuese në Afganistan (FLUOR)

Shteti	Numri i punëtorëve
Shqipëria	206
Bosnja dhe Hercegovina	1126
Kosova	868
Maqedonia	1395


Kriteret për punësim në këto kompani janë njohja e gjuhës angleze, përvoja paraprake për pozitën në të cilën aplikohet dhe suksesi në intervistën me rekrutët e kompanisë. Këto kriteret janë njëherazi edhe përcaktuese për pagën dhe pozitën që do të ushtrojë aplikanti. Për më tepër, punëtorët që aplikojnë për punë në Afganistan apo Irak u nënshtrohen analizave të plota shëndetësore të cilat për punëtorët kosovarë realizohen në Maqedoni⁷. Pozitat e punës në të cilat kosovarët më së shumti janë të punësuar janë:

⁶ Intervistë me drejtorin e agjencisë “Punësohu”, z. Balton Derguti.

⁷ Të dhënat nga intervistat me punëtorët kosovar në Afganistan.

depoist, specialist në shërbimet ushqimore, specialist për kontrollimin e materialeve, punëtorë për shërbimin e ushqimit, kuzhinier, punëtorë krahu, mekanikë, vozitës etj.

Grafikoni nr.3: Pozitat e punës në të cilat kosovarët më së shumti janë të punësuar



Burimi: Të dhënat nga intervistat me punëtorët në Afganistan dhe të dhënat e marrura nga bankat


Në bazë të intervistave me kosovarët që punojnë në Afganistan, kemi mësuar se orari i punës është 12 orë në ditë apo 84 orë në javë, duke përfshirë edhe fundjavën. Çdo punëtor i takojnë 4 pushime në vit, nga 21 ditë duke përfshirë udhëtimin dhe një shumë prej 2.700 dollarësh për çdo pushim, apo gjithsej 10.800 dollar në vit. Gjithashtu, punëtorët të cilët vazhdojnë punën me të njëjtën organizatë kontraktuese pas përfundimit të kontratës një vjeçare marrin rrogën e 13-të dhe kanë lehtësira në promovime dhe benefite shtesë. Me rastin e përmbyshjes së kontratës një vjeçare dhe për të vazhduar atë, punëtorët duhet t'u nënshtrohen analizave shëndetësore përsëri, këtë radhë në një qendër mjekësore në Dubai.

Sipas të dhënave zyrtare pagat ndahen në disa nivele, të cilat dallojnë sipas prejardhjes së shtetit. Kështu në nivelin e parë janë shtetasit amerikanë të punësuar direkt nga SHBA, në nivelin e dytë janë shtetasit amerikanë të punësuar nëpërmjet agjencive të punësimit. Niveli i tretë përbëhet nga shtetasit kanadezë dhe të Bashkimit Evropian, ndërsa në nivelin e katërt janë shtetasit e vendeve më të pazhvilluara, ku hyjnë edhe shtetasit e Ballkanit. Megjithatë kjo ndarje e pagave nuk është e vetmja, sepse pagat dallojnë edhe sipas profesionit që ushtrohet. Kështu paga bazë vjetore sillët prej 14.850 dollar - 29.700 dollar, ku përpos rrogës bazike punëtorët kanë edhe përfitime të tjera në të holla (e cila është e shkallëzuar dhe varet nga faktorë të shumtë), si dhe mbulesën për pushime (e cila është fikse 10.800 dollar në vit për një punëtor).

Të hyrat në Kosovë nga ky vend vlerësohen të jenë rreth 50-55 milion euro në vit, të cilat hyjnë nëpërmjet shtatë bankave që operojnë në Kosovë. Të dhënat nga shtatë bankat komerciale në Kosovë tregojnë se për gjashtë muaj, Janar-Qershor 2011, të hyrat nga Afganistani kanë qenë mbi 15 milion euro, prej 1.622 punëtorëve⁸.

Sipas të dhënave nga bankat që operojnë në Kosovë, shtrirja regjionale e punëtorëve nga Kosova që punojnë në Afganistan është e përqendruar në Ferizaj me 56% e totalit të punëtorëve kosovar në Afganistan, e pasuar nga Prishtina me 21% dhe Gjilani me 19%, ndërsa në përmasa më të vogla janë edhe punëtorët nga Mitrovica (2%), Gjakova (1%), Peja (0,7%) dhe Prizreni (0,3%). Kjo vjen edhe për shkak se komunat e Anamoravës janë më të informuara rreth mundësisë së punësimit në këtë shtet, krahasuar me komunat tjera dhe kjo kryesisht përmes KFOR-it amerikan të vendosur në këtë pjesë.

Grafikoni nr.4: Vendbanimi i të punësuarve kosovar në Afganistan sipas regjionit



Burimi: Bankat komerciale në Kosovë

Një pjesë e të hyrave nga dërgesat nga jashtë, përveç në konsum (33%) dhe në investime banimi dhe prona (12%), shpenzohen edhe në hapjen e bizneseve (11.4%)⁹. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë në mes të numrit të të punësuarve në Afganistan sipas regjioneve dhe numrit të bizneseve të regjistruara në ato regjione.

Po t'i analizojmë të dhënat e numrit të ndërmarrjeve sipas regjioneve si përqindje e numrit të popullsisë për komuna do të shohim se numri më i

⁸ Të dhënat zyrtare nga 7 bankat në Kosovë. Vetëm një bankë nuk ka pranuar të ofrojë të dhënat e tyre dhe të marrë pjesë në analizën tonë. Bankat të cilat i janë përgjigjur GAP-it me të dhënat e kërkuara për këtë kategori të punonjësve, kanë ofruar të dhënat e detajuara, por me kusht që ato të mos bëhen publike në formën e të dhënave për secilën bank veç e veç, por vetëm si shifër e përgjithshme. Andaj GAP duke respektuar kërkesën e bankave komerciale, publikon vetëm shifrën e përgjithshme të të hyrave nga Afganistani.

⁹ USAID dhe UNDP, "Studimi i Remitencave në Kosovë 2010".

madh i bizneseve është i përqendruar në rajonin e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit.¹⁰

Interesimi i institucioneve publike për shtetasit kosovar në Afganistan


Përkundër faktit se mbi 2.100 shtetas kosovar punojnë në Afganistan dhe mbi 55 milion euro dërgohen për çdo vit në Kosovë, institucionet shtetërore nuk kanë treguar interesim për këtë kategori të qytetarëve dhe të hyrave.

Derisa qeveritë e vendeve të rajonit po i kushtojnë një vëmendje të veçantë flukseve të dërgesave në strategjitë e tyre për zhvillim, Qeveria e Kosovës nuk e di saktësisht sa mjete hyjnë në vend dhe si shfrytëzohen ato. Qeveria ende nuk ka një strategji të zbatueshme për orientimin e dërgesave në zhvillimin ekonomik të vendit, veçanërisht në zonat e pazhvilluara ku kushtet e vështira ekonomike i detyrojnë qytetarët të emigrojnë.

Disa vite më parë Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale kishte lidhur marrëveshje me kompaninë kontraktuese ITT për tua përcjellë të dhënat e punë-kërkuesve të regjistruar, megjithatë rezultatet e këtij bashkëpunimi kanë ngelur në fazat fillestare pa dhënë ndonjë rezultat konkret në këtë drejtim.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dërgesat nga Afganistani deri më tani nuk i ka përllogaritur në analizat e saj periodike për remitencat. Në të dhënat e BQK-së për remitencat nuk zënë vend ato nga Afganistani. Nëse do të përllogariteshin edhe dërgesat nga Afganistani, atëherë ky vend do të radhitje si vendi i tretë, pas Gjermanisë dhe Zvicrës.

Grafikoni nr.5: Prejardhja e remitencave në Kosovë sipas vendit të origjinës



Burimi: Të dhënat e BQK për dërgesat e emigrantëve sipas shteteve (2011), kurse të dhënat për Afganistanin janë shtuar nga të dhënat e grumbulluara nga GAP

¹⁰ Agjencioni i Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve. Të dhënat për regjistrimin e bizneseve sipas komunave. 2011.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës nuk disponon të dhëna të sakta se sa është numri i të punësuarve në Afganistan¹¹. Marrë parasysh se kemi një numër të konsiderueshëm të moshës aktive për punë që janë të punësuar në Afganistan dhe Irak, dy vende të cilat konsiderohen zona lufte dhe me rrezikshmëri të lartë, qeveria e Kosovës duhet të ishte në gjendje të siguronte evakuim dhe mbështetje për shtetasit e saj në rast të rreziqeve të ndryshme.

Sipas Ligjit Bazë për Mbrojtje¹² në SHBA dhe Ligjit të SHBA mbi Kompensimin e Punëtorëve në Bregdet dhe në Port¹³ kompanitë janë të detyruar të raportojnë lëndimet, humbjet apo vdekjet e punëtorëve brenda 10 ditëve dhe më pas Divizioni i Punëtorëve raporton rastet e tilla në bazë të të cilave qeveria amerikane duhet të bëjë kompensimin e punëtorëve. Kështu të dhënat nga 1 Shtatori i vitit 2001 deri në 30 shtator të viti 2011 tregojnë për gjithsej 78.595 raste të ndryshme të lëndimeve të punëtorëve dhe 2.871 të vdekur.¹⁴

Në këtë listë figurojnë edhe 86 raste të të lënduarve nga Kosova, ku 63 nga të lënduarit është dashur të pushojnë nga puna për katër e më shumë ditë. Rasti i fundit i vrasjes së Z.B. nga Ferizaj, e cila humbi jetën në nëntor 2011 nga një shpërthim vetëvrasës, është një tjetër dëshmi për rrezikun që bartë të punësuarit në Afganistan.

¹¹ Ministria e Punëve të Jashtme, Mehmet Morina, Zyrtar i lartë për viza dhe pasaporta

¹² Ligjin Bazë për Mbrojtje mund ta lexoni në këtë link:

<http://www.propublica.org/documents/item/congressional-research-service-on-the-defense-base-act>

¹³ Ligji për Kompensimin e punëtorëve të Bregdetit dhe Portit mund ta lexoni në këtë link:

<http://www.dol.gov/owcp/dlhwc/lhwca.htm>

¹⁴ Përmbledhja e Raportit të Ligjit Bazë të Mbrojtjes sipas shteteve përkatëse <http://www.dol.gov/owcp/dlhwc/dbaallnation.htm>

Përfundimet dhe rekomandimet

Papunësia e lartë në Kosovë ka shtyrë shumë qytetarë të saj të kërkojnë punë jashtë vendit. Numri i të punësuarve jashtë vendit vazhdon të mbetet i lartë, e të larta mbesin edhe të ardhurat nga këto vende. Vetëm në Afganistan që nga viti 2002 e deri më tani konsiderohet se kanë qenë të punësuar në afate të ndryshme kohore rreth 7.000 shtetas kosovar. Kurse mesatarja vjetore e të punësuarve në Afganistan është rreth 2.100 veta. Kjo shifër e të punësuarve mbështetet nga të dhënat e marra nga bankat komerciale në Kosovë. Të hyrat nga Afganistani përlllogariten të jenë rreth 50-55 milion euro në vit. Rroga mesatare mujore për të punësuarit në Afganistan është 2.500 euro në muaj, që do të thotë se të ardhurat nga Afganistani janë të ardhurat më të larta për person, nëse krahasohet me dërgesat nga vendet tjera dhe numrin e shtetasve kosovarë të punësuar në vendet tjera.

Instituti për Studime të Avancuara GAP i rekomandon:

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS):

- MPMS të hartojë strategji dhe të shikojë mundësitë se si të papunët e regjistruar, të cilët në 2010 ishin 335.260, t'i lidh me kompanitë e mëdha ndërkombëtare, për punësime jashtë vendit. Qendrat rajonale dhe zyret komunale të punësimit duhet të kenë njohuri për tregje të tilla të punës dhe t'i informojnë punëkërkuesit për mundësitë e tilla, duke iu ofruar edhe asistencë në krijimin e lidhjeve.

Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ):

- MPJ, duke shfrytëzuar të dhënat nga kompanitë kontraktuese në Afganistan dhe nga bankat komerciale në Kosovë (apo BQK), të krijojë një regjistër me shtetasit kosovar të cilët ndodhen në këtë vend, apo edhe në zona tjera të luftës, me qëllim që shteti i Kosovës ta ketë më të lehtë reagimin në rastet kur jeta e shtetasve kosovarë rrezikohet. Rastet si vrasja e qytetares nga Ferizaj, apo rasti i vitit 2004, kur një punonjëse kosovare u rrëmbye në Afganistan, janë raste shqetësuese të cilat mund të përsëriten edhe në të ardhmen.

Bankës Qendrore të Kosovës (BQK):

- BQK të përlllogarit të hyrat nga Afganistani si pjesë e "dërgesave nga emigrantët", me qëllim që raportet për remitencat të jenë më të plota. Për shkak se dërgesat nga Afganistani vijnë kryesisht përmes sistemit bankar, kjo e bën shumë më të lehtë përlllogaritjen e kësaj kategorie të dërgesave.

Bankat komerciale:

- Me qëllim që të rritet niveli i dërgesave përmes sistemit bankar, bankat komerciale duhet të ulin tarifatat për dërgesa nga jashtë dhe të gjejnë mënyra se si t'i stimulojnë emigrantët që këto mjete të mbahen në bankat kosovare.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World



OPEN SOCIETY INSTITUTE
& Soros Foundations Network